

## FTESË PËR APLIKIM “GRANTE PËR BUJQËSI”

### Promovimi i aktiviteteve të përshatshme në adresimin e çështjeve të digjitalizimit dhe ndryshimeve klimatike në bujqësi

#### Rreth projektit

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës”, projekt tre-vjeçar (2023-2025), i përkrahur nga Donatori “Bread for the World” nga Gjermania dhe bashkëfinancuar nga komunat partnere.

IADK, përmes aktiviteteve të projektit, synon të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e teknologjive të reja që ndihmojnë në digjitalizimin e aktiviteteve në bujqësi. Po ashtu, synon që të promovoj dhe zbatoj intervenime të ndryshme që do të ju mundësoj fermerëve që të adresojnë ndryshimet klimatike, si në aspektin e zvogëlimit të efektit të dëmshëm që vë nga bujqësia dhe në përshtatjen me ndryshimet klimatike.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2024, IADK përmes projektit të sajë synon të mbështes fermerët e vegjël në sektorin e blegtorisë dhe hortikulturës (pemë dhe perime) me ide dhe aktivitete të përshatshme për digjitalizim dhe ndryshime klimatike.

#### Kush ka të drejtë aplikimi?

Të gjithë fermerët që merren me sektorin e blegtorisë dhe hortikultures

#### Fermerët nga cilat komuna do të mbështeten?

Vushtrri, Mitrovicë, Skënderaj, Drenas, Suharekë dhe Podujevë

#### Kushtet që duhet plotësuar për aplikim:

- Aplikuesi/ja duhet të jetë nga një prej komunave të lartëcekura si dhe investimet duhet të bëhen brenda territorit të komunës së lartëcekur;
- Aplikuesi/ja të jetë përgjegjës kryesor në menaxhimin e aktiviteteve ditore në fermë, inkurajohen aplikuesit/fermerët e rinj (18-35 vjeç);
- Aplikuesi/ja të ketë fermë me madhësi të vogël, por me potencial për të zgjeruar aktivitetin bujqësorë;
- Aplikuesi/ja të ketë burime të mjaftueshme si infrastrukturë dhe humane në zbatimin e projektit;
- Aplikuesi/ja të ketë gatishmëri në bashkëfinancimin e projektit/grantit;
- Aplikuesi/ja do të diskualifikohet nëse dëshmohet se ka përfituar grant të ngjashëm nga ndonjë donatorë tjetër, përfshirë edhe financime nga MBPZHR në 3 vitet e fundit;

#### Dokumentet për aplikim

- Aplikacionet mund të merren në zyrat e IADK-së dhe zyrat komunale për bujqësi në Vushtrri, Mitrovicë, Skënderaj, Drenas, Suharekë dhe Podujevë, ose mund të shkarkohen në linkun e cekur në njoftim.
- Aplikacioni duhet të përmbaj të gjithë informacionet e kërkuar, dhe duhet të dorëzohet në zyrat e IADK-së apo zyrat për bujqësi në komunat përkatëse, si dhe mund të dërgohet edhe në formën elektronike në e-mail adresën: [sylejmanbunjaku@hotmail.com](mailto:sylejmanbunjaku@hotmail.com) ose [hajraleonora@gmail.com](mailto:hajraleonora@gmail.com)
- Krahas aplikacionit, aplikuesi/ja duhet të dorëzojnë edhe:
  - a. Kopje të letërnjoftimit të aplikuesit
  - b. Kopje të certifikatës familjare të aplikuesit;
  - c. Certifikatën e NIF (nëse e posedoni)
- Aplikacioni me dokumentet tjera të kërkuara duhet të dorëzohet jo më vonë se data 04.10.2024.
- Për informacione shtesë mund të na shkruani në email adresën: [sylejmanbunjaku@hotmail.com](mailto:sylejmanbunjaku@hotmail.com) ose të nga kontaktoni në numrin e telefoni +383 44 412 475 nga ora 8:00 – 16:00.

## Mbështetja financiare

- Çdo grant i kërkuar nga IADK sipas kësaj thirrjeje për propozime duhet të jetë ndërmjet shumave minimale dhe maksimale të mëposhtme:
  - a. Vlera minimale: EUR 600.00
  - b. Vlera maksimale: EUR 1,500.00
- Aplikuesi/ja duhet të jetë i/e gatshëm për të bashkëfinancuar në projekt/grant.

## Kostot e pranueshme për financim:

Aktivitetet/kostot të cilët mund të financohen në kuadër të projektit, por pa u kufizuar në:

### I. Intervenimet potenciale për digjitalizim të aktiviteteve bujqësore (blegtori dhe hortikulturë)

<u>Blegtori</u>	<u>Hortikulturë</u>
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Zbulimi dhe menaxhimi i automatizuar i mastitit (Mastipro);</li><li>2. Optimizimi i mbarsjes së lopëve (Moonsyst Smart Cattle Monitoring Bolus)</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Përdorimi racional i ujit përmes instalimit të sistemi të ujitjes së kontrolluar - sensorve;</li><li>2. Përmirësimi i ajrosjes në serrë, përmes instalimit të sistemi i ajrosjes automatike.</li></ol>

### II. Intervenimet potenciale për adresimin e ndryshimeve klimatike

<u>Blegtori</u>	<u>Hortikulturë</u>
<ol style="list-style-type: none"><li>1. Përmirësimi i ventilimit në shtallë (hapje të dritareve apo hapsirave të nevojshme për ajrosje);</li><li>2. Vendosja e rretave për largimin e insekteve;</li><li>3. Mbjellja e pemëve – drunjëve hijezues rreth shtallës për të zvogëluar temperaturën në shtallë;</li><li>4. Menaxhimi i plehut, ndërtimi i hapsirave për vendosjen e plehut të shtallës.</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Grumbullimi i ujit të shiut nga serrat, vendosja e gypave dhe rezervuarit, lidhja e ujit nga rezervuari në sistem të ujitjes;</li><li>2. Vendosja e rretave për hijezim në serrë apo në fushë të hapur të kultivuara me pemë/perime;</li><li>3. Mbulimi i pemëve të imëta me serra tunele nga konstruksionet e lehta dhe foli dhe rrjeta për hijezim.</li></ol>

**Sqarim:** Në rastë se paketat e propozuara nga IADK nuk është në përputhje me kërkesat e fermës suaj, ju keni të drejtë që të propozoni ide ose modele tjera që janë të nevojshme. Kujdes: modelet/idetë që i propozoni duhet të jenë në adresim të ndryshimeve klimatike ose në zbatim të intervenimeve në digjitalizim të fermës – nëse janë jashtë këtyre dy temave, ato nuk do të merren në konsideratë.